VENDIM
Nr. 671, datë 15.10.2014

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 122, DATË 5.3.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "UNAZA E MADHE E TIRANËS (KOMUNA E PARISIT - RRUGA E KAVAJËS)""

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 122, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pikat 3, 4, 5, 6 dhe 8 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqet "tokë", me vlerë prej 464 014 103.6 (katërqind e gjashtëdhjetë e katër milionë e katërmbëdhjetë mijë e njëqind e tre pikë gjashtë) lekësh, "objekte", me vlerë 551 973 104 (pesëqind e pesëdhjetë e një milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e njëqind e katër) lekë, dhe "kultura bujqësore", me vlerë 1 561 500 (një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e pesëqind) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit për sipërfaqet "tokë", "objekte" dhe "kultura bujqësore" është 1 017 548 707.6 (një miliard e shtatëmbëdhjetë milionë e pesëqind e dyzet e tetë mijë e shtatëqind e shtatë pikë gjashtë) lekë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Vlera e përgjithshme e shpronësimit për sipërfaqet "tokë", "objekte" dhe "kultura bujqësore" prej 1 017 548 707.6 (një miliard e shtatëmbëdhjetë milionë e pesëqind e dyzet e tetë mijë e shtatëqind e shtatë pikë gjashtë) lekësh, e përbërë nga vlera 891 294 437 (tetëqind e nëntëdhjetë e një milionë e dyqind e nëntëdhjetë e katër mijë e katërqind e tridhjetë e shtatë) lekë, e miratuar me vendimin nr. 122, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, dhe vlera 126 254 270.6 (njëqind e njëzet e gjashtë milionë e dyqind e pesëdhjetë e katër mijë e dyqind e shtatëdhjetë pikë gjashtë) lekë, të përballohet nga buxheti i vitit 2014, i miratuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.".

"8. Pronarët e pasurive, për të cilat janë bërë shënimet "Konfirmuar nga ZVRPP-ja", "Proces regjistrimi", "Proces konfirmimi", "Certifikatë pronësie (pritet konfirmim nga ZVRPP-ja)", të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar. Të gjithë pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që janë në listat e shpronësimit, të likuidohen pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë nga ZVRPP-ja Tiranë.".

2. Në tabelat e pronave që shpronësohen, bashkëlidhur vendimit, të shtohen tabelat që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE
Lista e pronarëve, pasuritë e të cilëve shpronësohen nga ndërtimi i " Unaza e Madhe e Tiranes"
(Segmenti "Komuna e Parisit -Rruga e Kavajës") (shtesat, objektet)

Nr. rendor	PRONARI			Z. kadastrale	Nr. pasurie	Sipërfaqja e objekteve (banese) m^2	Çmimi mesatar(/m^2)	Vlera sipas çmimit mesatar (leke)	Sipërfaqja e objekteve (podrum+lokal)	Vlera sipas kostos së ndërtimit (lekë)	Vlera totale (lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri									
1	Fatime Fatmir Sejrije	Zeqo Faslli Hysen	Ymeri Ymeri Ymeri	8260	1/54+1-3	30	69,285	2,078,550			2,078,550	Konfirmuar ZVRPP
2	Bashkim	Shazima n	Agolli	8260	1/54+1-7	20	69,285	1,385,700			1,385,700	Konfirmuar ZVRPP
3	Njazi		Shaho	8260	2/266-ND	86	69,285	5,958,510			5,958,510	Konfirmuar ZVRPP
4	Bardhyl		Spaho	8260	2/437	42.5	69,285	2,944,613			2,944,613	Konfirmuar ZVRPP
5	Fadil	Nebi	Mejdani	8240	3/280-ND	130	69,285	9,007,050			9,007,050	Certifikate pronesie (pritet konfirmim nga ZVRPP)
6	Nebi		Mejdani	8240	3/265-ND	134	69,285	9,284,190			9,284,190	Certifikate pronesie (pritet konfirmim nga ZVRPP)
7	Shkelqi m Rabian	Bektash Adem	Barzezi Barzezi	8240	3/378-ND	155.6	69,285	10,780,746	115.2	8,245,961	19,026,707	Certifikate pronesie (pritet konfirmim nga ZVRPP)
8	Anisa Florjana	Servet Servet	Tenaj Zeqiri	8260	2/189-ND	50.9	69,285	3,526,607			3,526,607	Konfirmuar ZVRPP
9	Ionja sh.p.k			8240	3/238-ND	135.4	69,285	9,381,189			9,381,189	Konfirmuar ZVRPP
10	Petrit	Hyqmet	Mejdani	8240	3/381-ND	192	69,285	13,302,720			13,302,720	Certifikate pronesie
11	Tefik		Gjata	3292	291/177	68	69,285	4,711,380			4,711,380	Proces regjistrimi
12	Hasan		Zeqiri	3292	291/255/1	32	69,285	2,217,120			2,217,120	Proces regjistrimi
13	Skender		Zeqiri	3292	291/253/2	74	69,285	5,127,090			5,127,090	Proces regjistrimi
14	Ymer		Sula	3292	291/252/1	96	69,285	6,651,360			6,651,360	Proces regjistrimi
15	Haxhi	Ibrahim	Dushku	3292	291/251/1	70	69,285	4,849,950			4,849,950	Konfirmuar ZVRPP
16	Ramaza n Kumrije		Tufa Tufa	8260	1/282-ND	88.8	69,285	6,152,508			6,152,508	Konfirmuar ZVRPP
17	Besim	Beqir	Kaperi	3292	291/250	2	69,285	138,570			138,570	Konfirmuar ZVRPP
18	Ramaza n Donika		Serjani Shemshiri	8260	1/157-ND	61	69,285	4,226,385			4,226,385	Certifikate pronesie
19	Vitmon		Dhoraj	3292	291/175	50	69,285	3,464,250			3,464,250	Certifikate pronesie
	Shuma					**1518.2**		**101,724,237**	**115.2**	**8,245,961**	**109,970,198**	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE
Lista e pronarëve, pasuritë e të cilëve shpronësohen nga ndërtimi i "Unaza e Madhe e Tiranës"
(Segmenti "Komuna e Parisit -Rruga e Kavajës") (shtesat tokat)

Nr. rendor	PRONARI			Z. kadastrale	Nr. pasurie	VLERA E SHPRONËSIMIT			Vlera totale (lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri			Sip. (m^2)	Çmimi (lek/m^2)	Vlera (lekë)		
1	Njazi	Bejaz	Shaho	8260	2/433	400	10182	4072800	4072800	Konfirmuar ZVRPP
2	Fatime Fatmir Sejrije	Zeqo Faslli Hysen	Ymeri Ymeri Ymeri	8260	1/54+1-3	30	10182	305460	305460	Konfirmuar ZVRPP
3	Bardhyl	Islam	Spaho	8260	2/437	63.8	10182	649611.6	649611.6	Konfirmuar ZVRPP
4	Ymer		Sula	3292	291/252/1	118	10182	1201476	1201476	Proces Regjistrimi
5	Hasan		Zeqiri	3292	291/255/1	270	10182	2749140	2749140	Proces Regjistrimi
6	Skender		Zeqiri	3292	291/253/2	144	10182	1466208	1466208	Proces Regjistrimi
7	Sefer	Dule	Aga	3292	291/171/1	136	10182	1384752	1384752	Konfirmuar ZVRPP
8	Haxhi	Ibrahim	Dushku	3292	291/251/1	300	10182	3054600	3054600	Konfirmuar ZVRPP
9	Tefik		Gjata	3292	291/177	106.5	10182	1084383	1084383	Proces Regjistrimi
10	Anastas Jemin		Coli Coli	8240	3/234	31	10182	315642	315642	Proces konfirmimi
	Shuma					**1599.3**		**16284072,6**	**16284072,6**	